



## SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Aritech shpk" të datës 03.09.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "168 Pajisje IT – Tabela Digjitale" me nr. të prokurimit 616-25-6962-1-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

### V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Aritech shpk" të datës 03.09.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "168 Pajisje IT – Tabela Digjitale" me nr. të prokurimit 616-25-6962-1-1-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëjë korigjimin e kërkesave në dosjen e tenderit sipas të gjeturave të evidentuara më poshtë në këtë vendim.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik "Aritech shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 03.09.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "168 Pajisje IT – Tabela Digjitale" me nr. të prokurimit 616-25-6962-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

**7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.*

2/3

F02 Formulari Standard për rishqyrtim të vendimit në AK

Ne, si Operator Ekonomik i interesuar, në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik (LPP) dhe Rregulloren për Prokurim Publik (RRPP), ju paraqesim këtë kërkesë për rishqyrtim lidhur me procedurën e shpallur. Pas analizës së dokumentacionit të tenderit dhe metodologjisë së vlerësimit, kemi konstatuar se disa elemente bien ndesh me dispozitat ligjore dhe parimet bazë të prokurimit publik.

Identifikojmë dy çështje kryesore:

1. Specifikimet teknike kufizuese, të përshtatura për vetëm një prodhues.
2. Metodologjia e vlerësimit e padrejtë dhe joproportionale.

Duke qenë se kjo procedurë është kontratë komizë me afat 36 muaj, pasojat e specifikimeve diskriminuese dhe metodologjisë jo-proportionale janë edhe më serioze. Për tri vite me radhë, Autoriteti Kontraktues do të jetë i detyruar të furnizohet vetëm nga një prodhues i paracaktuar, duke përjashtuar konkurrencën reale dhe duke rritur rrezikun e shpenzimeve joefikase të fondeve publike. Kjo bie ndesh me parimin e përdorimit racional të buxhetit publik dhe cenon konkurrencën afatgjatë në treg.

**Analizë Teknike dhe Ligjore**

**1. Specifikimet Teknike Diskriminuese**

Pas shqyrtimit të specifikimeve, rezultoi se ato janë ndërtuar për të përjashtuar prodhues të tjerë dhe për t'iu përshtatur vetëm platformës SMART Technologies. Konkretisht:

- Përmendet SMART Board 75" si pajisje e kërkuar.

- Kërkohej që OE të jetë i autorizuar nga prodhuesi SMART.
- Specifikohen funksionalitete ekskluzive si SMART Ink dhe SMART Object Awareness, të cilat janë teknologji të patentuara të SMART.
- Softueri dhe shërbimet cloud të SMART përmenden si kërkesë e detyrueshme.
- Edhe aksesoret janë përshkruar si mbajtëse për Smart Board, duke përjashtuar alternativa neutrale.

Këto kërkesa shkelin nenin 28 të LPP dhe Pikën 19 të RRPP-së.

Po ashtu bien ndesh me nenin 7 të LPP, sepse krijojnë trajtim të pabarabartë dhe diskriminues.

Janë përjashtuese, duke e kufizuar konkurrencën vetëm tek një prodhues i vetëm, gjë që rrit rrezikun e çmimeve më të larta.

**Përgjigja nga AK:**

**Spec. Teknike:** Të ketë: SMART OBJECT AWARENESS - Të bëjë dallimin e prekjës kur preket me Laps të shkruaj, me gisht selekton/shkruan dhe të bëjë dallimin kur preket me shuplakën e dorës të fshiej, në të njëjtën kohë!!

Faqe 2 nga 5

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: [visar.shchu@rks-gov.net](mailto:visar.shchu@rks-gov.net)

**Arsyetimi:** Spec. teknike gjatë përpilimit janë marrë duke u bazuar në modelet më të avancuara të SMART BOARD - ve, nga të gjithë prodhuesit global, jo për të favorizuar një brand të caktuar.

**Vendimi:** Aprovohet pjesërisht kërkesa e OE - ARITECH SH.P.K., rrjedhimisht: largohet emertimi "SMART OBJECT AWARENESS", nga spec. teknike. *Mirë mbetet objektiva: "Tabela Interaktive, duhet automatikisht të njeh/ përkrah metodën e futjes së të dhënave nga forma të ndryshme (LAPS, Gishtë, Pëllëmbë të dorës apo Gomë të jashtme fizike, dhe të rregulloj funksionalitetin përkatës, (Shkrim, lëvizje apo fshirje). Pa pasur nevojë ndërrimin manual të mjetëve për funksionalitete të ndryshme. Këtë opsion e gjejmë të min. 4-5 Brande të njohura globalisht, sikurse është ViewSonic, Promethean etj.*

**Vendimi:** Aprovohet pjesërisht kërkesa e OE - ARITECH SH.P.K., rrjedhimisht: largohet emertimi "SMART INK", nga spec. teknike. *Mirë mbetet objektiva: "Shkrimi mbi aplikacione të tjera-Opsionale".*

- *"Shkrimi mbi aplikacione të tjera", Kur një kompjuter lidhet me Tabelën Interaktive, është e dëshirueshme (Opsionale) që softueri të ofrojë mësimdhënësit të shkruaj, shënoj ose vizatoj mbi dokumentet e hapura si: shfletues të internetit (Internet Browser), PDF, video, foto, PowerPoint, Word, Excel... dhe të ruhen ndryshimet dhe shkrimet në document.*
- *Të mundësoj ruajtjen e shkrimeve/vizatimeve mbi Explorer (Windows Explorer) apo dokumente si PDF, Video, Foto, Power Point, Excel, Word. Pra, shkrimi mbetet i integruar në atë faqe/dokument, jo vetëm si Screen Shot. Ofertuesit, mundë edhe të ofrojnë software THIRD PARTY - apo të palës së tretë apo të krijuar vetë që ofronë këtë mundësi.*

*Software dhe shërbimet në CLOUD, BENQ, ViewSONIC, Promethean, Samsung, Smart Technologies, Microsoft, të gjitha këto Brenda sikurse edhe shumë të tjera kanë softuer për edukim të integruar, dhe që mundën me u menaxhu dhe me shpërndaj materiale në CLOUD, qoftë në platformat e të njëjtit prodhues, qoftë duke përdorur platforma tashmë të njohura ndërkombëtare sikurse janë: GOOGLE, Microsoft, sikurse edhe CLOUD Server nga prodhuesit e Tabelave të Mëcurës. Dhe kërkesa është shumë e qartë, "Të ofroj mundësinë e instalimit të softuerit në versionin Desktop në kompjuterin e klasës apo paisjen e mësimdhënësit. Të njëjtat dokumente të krijuara në versionin Desktop duhet të hapen edhe në versionin Android direkt nga tabela (pa PC) apo në versionin Web dhe të ruhen në cloud platformën e prodhuesit apo platforma - Third-Party (të palës së tretë)". D.M.TH. është e lejueshme edhe Third-Party Application.*

**Vendimi i AK.** Aprovohet pjesërisht / Largohen objektivat "termet", mbeten objektivat / opsionet / specifikat teknike të kërkuara sipas paramasës. Përditësohet paramasa.

**Pretendimi Ankimor r. 2:**

## Metodologjia e Vlerësimit të Ofertave

Sipas dokumentacionit, çmimi është ndarë në grupe produktesh me peshë të ndryshme:

- Grupi A (artikuj dytësorë, me vlerë të vogël) – 50% e peshës.
- Grupi B – 30% e peshës.
- Grupi C (pajisjet kryesore, si tabelat interaktive) – vetëm 20% e peshës.

Ky sistem është problematik sepse artikujt me vlerë minimale janë mbivlerësuar, ndërsa pajisjet kryesore janë nënvlerësuar. Lejon manipulim të ofertave dhe shkel Nenin 59 të LPP dhe Pikën 40 të RRPP-së, pasi nuk garanton vlerësim proporcional dhe të drejtë. Nuk reflekton realisht koston dhe vlerën për para, duke çuar në zgjedhjen e ofertës më pak të favorshme financiarisht për AK.

Në bazë të sa më sipër, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues:

1. Rishikimin e specifikimeve teknike
2. Rishikimin e metodologjisë së vlerësimit, në mënyrë që peshët e çmimit të jenë proporcionale.
3. Nëse korrigjimet nuk janë të mundshme brenda procedurës aktuale, kërkojmë anulimin e saj dhe rihapjen me kritere neutrale dhe jo-diskriminuese.

Ky rishqyrtim synon të garantojë një proces prokurimi të drejtë, transparent dhe konkurrues, në përputhje me ligjin dhe interesin publik. Ndryshimet e propozuara do të mundësojnë pjesëmarrje më të gjerë të operatorëve ekonomikë, duke sjellë oferta më cilësore dhe më të favorshme financiarisht për Autoritetin Kontraktues.

**Përgjigja nga AK:** *Renditja e Produkteve sipas Tabelave: Grupi A, Grupi B dhe Grupi C, është bërë sipas prioritetit të punëve dhe të furnizimeve që do të kryehen sipas publikimit të njoftimit me nr. të prokurimit 616-25-69-62-1-1-1 dhe kërkesa për sasi është për 1 njësi, që do të thotë se kërkesa për kabull UTP mundet me qenë 1, 10, 100, 1000, 10 000 etj. Sikurse edhe për pajisje tjera, varet nga vendi "shkolla" ku do të implementohet projekti dhe cfare sasie nevojitet për me përfundu shkollën në fjalë, sikurse dhe për pajisje të tjera të Rrjetave Aktive, dhe për Tabela të Mencura. Gjithësesi forma e vlerësimit të procedurës së tenderimit për të gjithë OE – është e njejtë dhe si e till nuk përbën shkelje të transparencies apo diskreditim të OE. Dhe si e tillë forma aktuale qendronë. AK – Konsideron se pretendimet Ankimore të OE – Aritech shpk. janë të PA – BAZUARA.*

Përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kërkuese.

Vlen të citohet neni 7 paragrafi 2 të LPP përmes të cilit përcaktohet se *"Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik"*.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 09.09.2025

**Visar SHEHU**  
  
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

#### **Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.